



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

DATE/A:	24.01.2023
PËR/ZA/TO:	"PHARMA LEADER" L.L.C., Z. Veton Sadiku
Cc:	Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm
NGA/OD/FROM:	Berat Marmullaku, zv. Udhëheqës i Div. Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	VENDIM, mbi rishqyrtimin e Kërkesë për Rishqyrtim te datës 24.01.2023

Te nderuar,

Autoriteti Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë, ne bazë të nenit 108A te Ligjit Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, e ka shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim te datës 20.01.2023 qe e keni dërguar për tenderin "Furnizim emergjent me Insulina Analoge nga Lista Esenciale" me numër prokurimi 206-22-14292-1-1-5 dhe nr. te brendshëm 206-22-65-1-1-5 dhe mori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET**, si e pa bazuar Kërkesa për Rishqyrtim e OE "PHARMA LEADER" L.L.C. - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim emergjent me Insulina Analoge nga Lista Esenciale" me numër prokurimi 206-22-14292-1-1-5 dhe nr. te brendshëm 206-22-65-1-1-5, mbi Njoftimin e Vendimit te AK, te publikuar ne E-prokurim me datën 12.05.2022.
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim emergjent me Insulina Analoge nga Lista Esenciale" me numër prokurimi 206-22-14292-1-1-5 dhe nr. te brendshëm 206-22-65-1-1-5.
- III. **AK - MSh**, ka nënshkruar kontratën për aktivitetin e prokurimit "Furnizim emergjent me Insulina Analoge nga Lista Esenciale" me numër prokurimi 206-22-14292-1-1-5 dhe nr. te brendshëm 206-22-65-1-1-5.

Pretendimet Ankimore te OE ne Kërkesën për Rishqyrtim te datës 20.01.2023

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Neni 1, 6, 7, 10, 27, 28, 35, 42, 51, 56, 69, 70, 105, 106, 116, te LPP-së

Neni nga 40 deri 50, i rregullores se KRPP-së 001/2022

7. Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

1. Pretendime penale për abuzim me paranë publike dhe me dispozitat e mundshme ligjore.
2. Pretendime për shkelje ligjore qe ndërlidhën me nenin 42 (par 42.1; 42.2; 42.3; 42.4; 42.5; 42.6; 42.7) te rregullores se KRPP-së 001/2022.
3. Pretendime për shkelje ligjore qe ndërlidhën me nenin 48 (par 7, 48.4; 48.2; 48.3) te rregullores se KRPP-së 001/2022.
4. Pretendime për shkelje ligjore qe ndërlidhën me nenin 97.1 (par d, e, f, g, h, k, l, m, o, p) te rregullores se KRPP-së 001/2022.
5. Pretendime qe ndërlidhën me Vendimet e OSHP-se: Nr. 240/21; 397-409/22; 596/22.
6. Pretendimi qe ndërlidhet me Vendimin e KRPP-se nr. 67/22.
7. Pretendimi qe ndërlidhet me dy vendimet e Gjykatës Themelore Departamenti administrativ ku padia dhe kërkesë padia është hedhur si e pa lejuar.

Prandaj, kompania Pharma Leader LLC, kërkon shqyrtimin e kësaj kërkesë, përkatësisht shkëputjen e kësaj kontrate si te kundërligjshme para se neve ti kërkojmë te drejtat tona tani me 7 here te konfirmuara, meqë këto veprime janë hije e zeze jo për Autoritetin tuaj Ministrinë e Shëndetësisë por për tere Republikën e Kosovës.

Te respektohen vendimet e organeve gjegjëse OSHP dhe KRPP, procesi i rregullt i këtij aktiviteti te prokurimit te kthehet ne Rivlerësim dhe Kompania jone te shpallet e përgjegjshme sipas vendimit fillestar dhe vendimeve tjera.

8. Dëmet materiale

Te konsiderueshme, por ne proces te kalkulimit

Konstatimet e AK

Pretendimet e juaj ankimore ne Kërkesën për Rishqyrtim te dt. 20.01.2023 i konsiderojmë si te pa bazuara dhe qe dalin përtej kompetencave dhe subjektit te trajtimit te Kërkesës për Rishqyrtim.

1. Pretendimi i parë - I pa bazuar. Çështjet penale nuk janë subjekt i trajtimit te Kërkesës për Rishqyrtim.

2. Pretendimi i dytë - I pa bazuar. Kërkesa juaj për rishqyrtim nuk e pengon nënshkrimin e kontratës bazuar ne paragrafin 4.1 te nenin 26 te LPP-se

1.1. Së paku dhjetë (10) ditë kanë kaluar nga data e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës; **me kusht që, ky kusht të mos aplikohet për prokurimet urgjente që sipas nenit 35.2.1 (iii).** Apo për një aktivitet të prokurimit të bazuar në nenin 36. Apo për kontrata me vlerë minimale;

Dispozitat e nenit 42 te rregullores se KRPP-së 001/2022, kane te bëjnë me Njoftimet e tenderuesve ne procedurat e rregullta, me përjashtim te paragrafit 42.2 ku specifikohet se:

42.2 Në procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, tenderuesit/kandidatët dhe çdo palë e interesuar duhet të informohen nga AK përmes publikimit të Formularit B58 – **“Njoftimit mbi Vendimin e AK” dhe Njoftimit për dhënie të kontratës (B08) njëkohësisht,** dhe nga i cili publikim fillojnë afatet kohore për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave.

Sqarim: Duke marre parasysh qe sipas nenin 42.2 “Njoftimi mbi Vendimin e AK” dhe Njoftimi për dhënie të kontratës (B08) publikohen njëkohësisht, d.m.th. nuk kemi afat 5 ditësh ankimor ne mes këtyre dy njoftimeve sikur tek procedurat e rregullta. OE mund ta ushtrojne te drejtën e ankimit por nuk mund ta pengojnë kontraktimin. Kjo është e mbështetur ne nenin 48.2 te LPP-se ku specifikohet se: **“Nuk ka afate minimale kohore që lidhen me kryerjen e kësaj procedure”.**

3. Pretendimi i tretë - I pa bazuar. Dispozitat e nenit 48 te rregullores se KRPP-së 001/2022, i kemi plotësuar ne këtë procedure Emergjente, ku ne paragrafin 48.2 specifikohet se:

48.2 Për rastet e emergjencës ekstreme – ekziston mundësia të përdoret procedura e negociuar pa publikuar njoftimin e kontratës, neni 35.2.1(iii) i LPP-së. **Kjo procedurë mund të zhvillohet me një ose me shumë Operatorë ekonomik të zgjedhur nga autoriteti kontraktues. Nuk ka afate minimale kohore që lidhen me kryerjen e kësaj procedure.**

48.4 Megjithatë, kërkesat e nenit 35.3 të LPP-së do të merren parasysh nga autoriteti kontraktues: Zhvillimi i një procedure të negociuar pa publikuar njoftimin e kontratës në asnjë mënyrë nuk do t’ia heq autoritetit kontraktues obligimet e veta për të:

a. Luajtur një rol aktiv në vendosjen e kushteve të kontratës, posaçërisht lidhur me çmimet, afatet e dërgesave, sasi të, karakteristikave teknike dhe garancionet;

- E kemi plotësuar ne përpikmeri. Si rezultat i vendosmërisë se AK për mbrojtjen e buxhetit dhe furnizimin e qytetareve me Insulina, kemi arritur qe gjate negociimit për sasinë e parapare, zbritja te jete ne total për Lot 1 dhe Lot 2 = 89,078.55 €.

- b. Sigurojë se çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi përkatës i tregut; dhe
- E kemi plotësuar ne përpikmeri. Çmimet e kontratës janë me te ulëta se sa te oferta juaj e tenderit me ankesa te vitit 2020, andaj edhe narrativi i krijuar qe dy vite kinse për dëmtim buxheti, tanimë nuk është relevant.
- c. Vlerësojë me kujdes cilësinë e produktit në fjalë, të shërbimeve, apo punimeve.”
- E kemi plotësuar ne përpikmeri. I kemi kontraktuar produktet e regjistruara me AM konform legjislacionit ne fuqi.

48.5 Kurdo që Autoriteti Kontraktues përdor procedurën e negociuar pa publikuar Njoftimin e Kontratës, sipas nenit 35.2.1(iii) të LPP-së, Autoriteti Kontraktues do të njoftojë KRPP-në duke përdorur formën standarde.

- E kemi plotësuar, e kemi njoftuar KRPP-ne përmes shkresës se aprovuar nga ZKA B50 Njoftim për përdorimin e procedurës se negociuar pa publikim te njoftimit për kontrate. Nga KRPP nuk kemi pranuar ndonjë opinion për mos vazhdim te procedurës.

4. Pretendimi i katërt - I pa bazuar. Pikat d, e, f, g, h, k, l, m, o, p, te nenit 97 te rregullores se KRPP-së 001/2022, nuk i përkasin këtij aktiviteti - procedure emergjente. Shumica e pretendimeve kane te bëjnë me aktivitetin e hapur te vitit 2020.

Për informimin tuaj, sasia e Insulinave Analoge është ne përfundim, dhe ne me qellim qe mos te mbesin rreth 16,000 qytetar insulinvartes pa insulina, e kemi nënshkruar kontratën e Negociuar, ne te cilën është specifikuar se: “ne momentin qe te nënshkruhet kontrata e rregullt me procedure te hapur, kjo kontrate e negociuar ndërpritet automatikisht, pavarësisht përqindjes se realizimit te kontratës dhe AK-MSh nuk merr obligime ndaj kontraktorit”.

5. Pretendimi i pestë - I pa bazuar. Vendimet e OSHP-se te cekura nga ana juaj nuk i përkasin këtij aktiviteti. Për informimin tuaj Ministria e Shëndetësisë, konform kompetencave te veta ligjore, vendimin e fundit te OSHP-se për lenden e Insulinave te vitit 2020 e ka atakuar ne Gjykatën kompetente dhe ne jemi ne pritje te një Vendimi përfundimtar nga Gjykata.

Ministria e Shëndetësisë, prioritet e ka mbrojtjen e jetës dhe shëndetit te qytetareve, respektimin e ligjeve ne fuqi, mbrojtjen e buxhetit përmes blerjeve sa me te arsyeshme nga aspekti financiar siç është rasti me këtë kontratë, si dhe siguria ne kualitet e produkteve te regjistruara.

6. Pretendimi i gjashtë - I pa bazuar. Vendimi i KRPP-se nuk i përket këtij aktiviteti, as nuk janë subjekt i trajtimit te Kërkesës për Rishqyrtim.

7. Pretendimi i shtatë - I pa bazuar. Vendimet e Gjykatës nuk i përket këtij aktiviteti, as nuk janë subjekt i trajtimit te Kërkesës për Rishqyrtim.

ARSYETIM

AK-MSh sipas kërkesës për tenderim nga Njësia e Kërkesës, bazuar ne stokun aktual te insulinave, sigurimin e mos ndërprerjes se furnizimit dhe domosdoshmërisë për furnizim te mbi 15,000 pacienteve insulinvartes, jemi te detyruar për kontraktimin e këtyre produkteve, ne te kundërtën dështimi i kontraktimit dhe furnizimit me Insulina Analoge, do ta rrezikonte shëndetin publik te qytetareve te vendit.

Para tenderimit emergjent e kemi konsultuar Listën e AKPPM-se mbi produktet e regjistruara me Autorizim Marketing, konform legjislacionit ne fuqi.

Ministria e Shëndetësisë obligohet qe te zbatoj Ligjin NR. 04/L -190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale, si dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2022 qe është ne fuqi.

Si Divizion i Prokurimit ne MSh, duke marre parasysh interesimin tuaj për këto produkte, ju inkurajon qe ta beni regjistrimin e produkteve ne AKPPM konform legjislacionit te fuqi dhe pasi ti regjistroni produktet, do ju ftojme dhe mund te merrni pjesë ne tenderët e MSh-se, me ç`rast ju sigurojmë se do te jeni i barabarte ne konkurrencë me operatoret e tjerë konform nenit 7 te LPP-se.

Autoriteti Kontraktues nga sqarimet e prezantuara me lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshille juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankese pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. 1 x 1 OE "PHARMA LEADER" L.L.C. - Prishtinë
2. 1 x 1 OE te interesuar.

Me respekt.